13	Percaktimi i sulfurit ne karburante
14	Analiza e fijeve sintetike dhe atyre artificiale
15	Vleresimi i dyte intermedier
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes	
<p>Vijimi i rregulte i ligjëratave dhe ushtrimeve</p> <ul style="list-style-type: none"> - Bashkëpunim i bazuar në rregullat universitare - Respektimi i orarit të mësimit dhe konsultimeve - Respektimi të specifikave laboratorike dhe atyre mësimore <p>- Respektim i kodit dhe Statutit të Universitetit</p>	

Formular për SYLLABUS të Lëndës

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	FSHMN: Departamenti i Kimise
Titulli i lëndës:	Programimi në Kimi inxhinierike
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	I-rë / Semestri i II-të
Numri i orëve në javë:	2 + 2
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	-
Mësimdhënësi i lëndës:	Jeton Halili
Detajet kontaktuese:	Email: jeton.halili@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	<p>Aplikimi i informatikës në shkencën e kimisë është një fushë që përdor teknologjinë për të kuptuar më mirë proceset kimike. Një pjesë e rëndësishme e kësaj fushe është shfrytëzimi i sistemeve operative si Windows 10 dhe rrjeteve kompjuterike për të mbledhur dhe analizuar të dhëna. Paketa Microsoft Office, si Word dhe Excel, janë të rëndësishme për punën e një kimisti. Word përdoret shpesh për të shkruar dokumente shkencore dhe citimi i burimeve të informacionit dhe inkuadrimi i referencave është një pjesë kritike e këtij procesi. Excel përdoret për të analizuar të dhënat dhe për të bërë punë statistikore, ndërsa vizualizimi i të dhënave është një mjet i fuqishëm për të kuptuar më mirë rezultatet. Power Point përdoret për prezantime, ndërsa Access përdoret për të mbajtur dhe organizuar të dhënat. Kërkimi i informatave shkencore në internet është bërë më i lehtë nga teknologjia dhe programet aplikative. Përdorimi i Chemdraw dhe ACD/ChemSketch përdoren për të vizualizuar strukturat kimike.</p>
Qëllimet e lëndës:	<p>Në këtë lëndë, studentët do të mësojnë se si funksionojnë sistemet operative dhe rrjetet kompjuterike. Gjithashtu, ata do të mësojnë të përdorin paketën Microsoft Office për të punuar me dokumente, tabela dhe prezantime. Do të kuptojnë teknikat e citimit të burimeve të informacionit dhe inkuadrimit e referencave në dokumentet në Word.</p> <p>Studentët do të mësojnë teknikat e llogaritjes së thjeshtë dhe të avancuar në statistikë në Microsoft Excel dhe si të vizualizojnë të dhënat në mënyrë të përshtatshme. Ata gjithashtu do të kuptojnë si të përdorin Microsoft Office - Access për të krijuar dhe menaxhuar bazat e të dhënave. Një tjetër program aplikativ që do të trajtohet në këtë lëndë është Chemdraw dhe ChemSketch, të cilat përdoren për të vizualizuar dhe modifikuar strukturën e molekulave kimike, reaksionet dhe spektrat.</p> <p>Përveç kësaj, studentët do të mësojnë teknikat e kërkimit të informatave shkencore në internet dhe prezantimit të seminareve në mënyrë efektive. Kjo do të ndihmojë në rritjen e aftësive të tyre për të kuptuar, analizuar dhe prezantuar informacione të rëndësishme në fushën e inxhinierisë kimike.</p>

Rezultatet e pritura të nxënies:	<p>Pas përfundimit të këtij moduli, studentet do të jenë në gjendje: Të jenë në gjendje të përdorin sistemet operative dhe rrjetet kompjuterike për të kryer punë të ndryshme Të kenë njohuri të thella të paketës Microsoft Office dhe të jenë në gjendje të krijojnë dokumente, tabela dhe prezantime të ndryshme Të kenë njohuri të thella të Excel për të kryer llogaritje të ndryshme dhe vizualizim të të dhënave në mënyrë efektive Të jenë në gjendje të krijojnë dhe të menaxhojnë bazat e të dhënave në Access Të jenë në gjendje të vizualizojnë strukturat e molekulave kimike me ndihmën e softuerit Chemdraw dhe ChemSketch Të jenë në gjendje të kërkojnë dhe të përdorin burime shkencore në internet Të jenë në gjendje të prezantojnë seminare në mënyrë efektive.</p>		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënës të studentit)			
Aktiviteti	Aktiviteti	Aktiviteti	Aktiviteti
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike	1	10	10
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	5	5
Ushtrime në teren			
Kollokfiume,seminare	2	5	10
Detyra të shtëpisë	1	5	5
Koha e studimit vetanë të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	15	15
Përgaditja përfundimtare për provim	1	5	5
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	2	3	6
Projektet,prezentimet ,etj	3	3	9
Totali	16	81	125
Metodologjia e mësimdhënies:	Ligjërata, punë seminarike, punë në grupe, diskutime, prezantime.		
Metodat e vlerësimit:	Vlerësimi i parë 10% Vlerësimi i dytë: 20% Vlerësimi i tretë: 20% Detyrat e shtëpisë dhe seminarët: 10% Vijueshmëria : 5% Provimi përfundimtar: 35% Total 100% Notimi përfundimtar: 51%- 60% = 6 61% -70% = 7 71% - 80% = 8 81% - 90% = 9 91%-100% =10		
Literatura			

Literatura bazë:	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Principles of Data Analysis and Visualization in the Chemical Sciences" by Pedro Brandão and Lucas Rusak 2021 ✓ Ramesh Kumari, Computers and their Applications to Chemistry, Narosa 2002 ✓ Illustrated Microsoft Office 365 & Office 2019 Introductory (MindTap Course List) 1st Edition by David W. Beskeen , Carol M. Cram, Jennifer Duffy, Lisa Friedrichsen, Lynn Wermers 2019.
Literatura shtesë:	<ul style="list-style-type: none"> • Computational Chemistry: Introduction to the Theory and Applications of Molecular and Quantum Mechanics" by Errol G. Lewars 2011

Plani i dizajnuar i mësimi:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
<i>Java e parë:</i>	Aplikimi i informatikës në shkencën e kimisë
<i>Java e dytë:</i>	Sistemet Operative (Windows 10)
<i>Java e tretë:</i>	Sistemet dhe rrjetet kompjuterike
<i>Java e katërt:</i>	Paketa Microsoft Office (Word)
<i>Java e pestë:</i>	Citimi i burimeve të informacionit dhe inkuadrimi i referencave në WORD.
<i>Java e gjashtë:</i>	Excel (Aplikimi i funksioneve të thjeshta dhe logjike)
<i>Java e shtatë:</i>	Përpunimi statistik i rezultateve në Excel
<i>Java e tetë:</i>	Excel (Vizualizimi i të dhënave)
<i>Java e nëntë:</i>	Vlerësim (kollektivum)
<i>Java e dhjetë:</i>	Power point
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Access
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Kërkimi i informatave shkencore në Internet
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Programet aplikative Chemdraw dhe ACD/ChemSketch
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	Prezantimi i seminareve
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Vlerësimi i dytë

Ushtrimet praktike	
Nr.	Ushtrimet laboratorike:
•1•	Kompjuteri
•2•	Instalimi dhe konfigurimi i sistemit operativ Windows 10
•3•	Përdorimi i shërbimeve të Windows 10
•4•	Formatimi i dokumentit në word, Gjenerimi i përmbajtjes, listes së tabelave dhe listës së figurave,
•5•	Citimin e burimeve të informacionit dhe inkuadrimi i referencave në Word, Përdorimi i programeve aplikative si Mendely.
•6•	Aplikimi i funksioneve të thjeshta dhe logjike në Excel
•7•	Vizualizimi i të dhënave në Excel përmes diagrameve të ndryshme, ndërtimi i drejtëzës kalibruese për përcaktim sasior në kimë.
•8•	Përpunimi statistik i rezultateve në Excel: mesatarja, mediana, modi, variacioni, devijimi standard dhe korelacioni.
•9•	Vlerësimi i parë
•10•	Përdorimi i Power Point për prezantime

•11•	Përdorimi i Access për menaxhimin e bazave të të dhënave
•12•	Përdorimi i ChemDraw për vizualizimin e strukturave kimike
•13•	Përdorimi i ACD/ChemSketch
•14•	Prezantimi i seminareve
•15•	Vlerësimi i dytë

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Vijimi i rregulltë në ligjërata dhe ushtrime si dhe aktiviteti gjatë orëve të mësimit. Përdorimi i telefonave mobil në ligjërata dhe ushtrime është i ndaluar.

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Departamenti i Kimisë, FSHMN
Titulli i lëndës:	Spektroskopia molekulare
Niveli:	Bachelor – programi Kimi Inxhinierike
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	III (tretë) / Semestri i V
Numri i orëve në javë:	2+1
Vlera në kredi – ECTS:	3
Koha / lokacioni:	Orari del në tabelë të shpalljeve/ Departamenti i Kimisë
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Dr. Ramë VATAJ
Detajet kontaktuese:	Email: rame.vataj@uni-pr.edu Tel: /038-229-964/
Përshkrimi i lëndës	
Përshkrimi i lëndës	<p>Teknikat spektroskopike që përdoren në analizën e strukturës së molekulave, parimet baze, nocionet, aplikimi. Spektroskopia e absorbimit molekular (UV-VIS, IK), parimet e teknikave, instrumentet. Spektroskopia IK-ATR. Fluoreshenca dhe lumineshenca molekulare. Spektroskopia me rreze X, parimet bazë, instrumentet.</p> <p>Spektroskopia atomike, Spektroskopia e absorbimit atomik (SAA) dhe fluoreshencës atomike, parimet bazë, instrumentet. Spektroskopia atomike e emitimit (SAE, OES), spektroskopia atomike e masës, spektroskopia atomike me rreze X, parimet bazë, instrumentet. Ndikimi i disa parametrave në leximin dhe interpretimin e spektrave dhe gjetja e strukturës së molekulës me ndihmën e teknikave të ndryshme që janë mësuar.</p>
Qëllimet e lëndës:	Në kuadër të kësaj lënde studentët do të kenë mundësin të njihen me aplikueshmërinë e teknikave të ndryshme spektroskopike në studimin dhe karakterizimin e materialeve, komponimeve apo elementeve kimike. e poashtu do të njohin bazën teorike të këtyre teknikave dhe instrumentet përkatëse.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit të këtij moduli, studenti do të jenë në gjendje : Të njohin bazën teorike të teknikave të

	<p>spektroskopisë molekulare.</p> <p>Të kenë bazë të mirë në aspektin praktik rreth teknikave të ndryshme për karakterizimin e materialeve të ndryshme, substancave apo elementeve kimike.</p> <p>Të jenë në gjendje të vlerësojnë dhe të zgjedhin teknikat analitike të veçanta në analizën e materialit, komponimit apo elementit të caktuar.</p> <p>Fitojnë njohuri rreth interpretimit të spektrave.</p> <p>Fitojnë njohuri rreth përcaktimit të strukturës së molekulës.</p>		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	2/ 15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	1	1/15	15
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	5	5
Ushtrime në teren			
Kollokfiime, seminare	2	5	4
Detyra të shtëpisë			
Koha e studimit vetanë të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	10	10
Përgaditja përfundimtare për provim	3	3	9
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	2	1	2
Projektet, prezentimet ,etj			
Totali			75
Metodologjia e mësimdhënies:	Ligjërata (metoda interaktive dhe monolog), punim seminarik, ushtrime praktike dhe numerike, diskutim, punë në grupe.		
Metodat e vlerësimit:	<ul style="list-style-type: none"> • Pjesëmarrja aktive në ligjërata dhe ushtrime 10 % • Punimi seminarik 20 % • Vijimi i rregullt 10 % • Provimi final (me shkrim) 60 % 		

Literatura	
Literatura bazë:	<i>Chemical Analysis, Modern Instrumentation Methods and Techniques</i> , second edition, Francis Rouessac and annick Rouessac, Wiley-VCH, (2007). <i>Characterization of Materials</i> , Elton Kaufmann, John Wiley & Sons Inc (2012).
Literatura shitesë:	<i>Principles of Instrumental Analysis</i> , seventh edition, Douglas A. Skoog, F. James Holler, Stanley R. Crouch, Cengage Learning, USA, (2007). <i>Surface and Thin Film Analysis</i> , Gernot Friedbacher, Henning Bubert, Wiley-VCH, (2011).

Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjëratat që do të zhvillohet
Java e parë:	Natyra e rrezatimit elektromagnetik. Bashkëveprimi i rrezatimit elektromagnetik me materien.
Java e dytë:	Spektroskopia UV-VIS. Regjioni spektrali i UV-VIS dhe origjina e absorbimeve. Spektri UV-VIS. Kalimet elektronike në komponimet organike.
Java e tretë:	Grupet kromofore. Instrumentet në spektroskopinë UV-VIS. Spektrofotometrat UV-VIS (me një dhe dy rreze). Analiza sasiore në spektroskopinë UV-VIS - Ligji i Lambert-Beer-it. Metodatat kuantitative të analizës në spektroskopinë UV-VIS. Interpretimi i spektrave UV-VIS.
Java e katërt:	Spektroskopia Infra e Kuqe (IK). Origjina e absorbimit të dritës në regjionin IK. Absorbimet në IK. Shiritat rrotullues-luhatës në regjionin IK. Modelet e thjeshtuara të interaksionit vibracional.
Java e pestë:	Teknikat të cilat shfrytëzojnë reflektimin nga mostrat e ngurta. Spektroskopia IK me atenuim total (ATR). Teknika e IK e reflektimit spekular. Imazheria IK. Analiza kualitative dhe kuantitative në IK.
Java e gjashtë:	Fluorimetria dhe Kemiluminishenca. Fluoreshenca dhe fosforeshenca. Origjina e fluoreshencës. Marrëdhënia ndërmjet fluoreshencës dhe përqendrimit. Përthyerja Rejlehut dhe shiritat Raman.
Java e shtatë:	Instrumentet në fluorimetri. Aplikimet e teknikës

	fluorimetrike. Kemilushenca.
Java e tetë:	Vlerësimi i parë intermediar
Java e nëntë:	Spektroskopia me rreze X. Parimet bazë. Spektri me rreze X. Mënyrat e eksцитimit të elementeve në spektroskopinë me rreze X. Burimet e radio-izotopeve të rrezeve X. Burimet e tjera të eksцитimit.
Java e dhjetë:	Detektimi i rrezeve X. Instrumentet me energji dispersive në spektroskopinë me rreze X (EDXRF). Përgaditja e mostrës për matje në EDXRF.
Java e njëmbëdhjetë:	Spektroskopia atomike e absorbimit, teknika e emetimit me flakë. Efekti i temperaturës në elementin kimik. Spektroskopia e absorbimit atomik (SAA) kundrejt asaj të emetimit me flakë (SEF) . Matjet me me SAA dhe SEF.
Java e dymbëdhjetë:	Instrumentet SAA. Llampat me katodë boshe. Paisjet termike për përfitim të aerosolëve atomikë. Atomizimi me flakë. Atomizimi termoelektrikë. Avullimi kimik. Fotometrat me flakë. Korigjimi i absorbimeve të interferencave. Korigjimi i prapavijës.
Java e trembëdhjetë:	Spektroskopia atomike e emisionit. Spektroskopia optike me emision (OES). Parimet e analizës me emision atomik. Disocimi i mostrës në atome dhe jone. Eksцитimi i mostrës me shkëndija elektrike apo laser.
Java e katërbëdhjetë:	Sistemet dispersive dhe vijat spektrale. Instrumentet me skanim të gjatësisë valore. Performanca dhe rezolucioni i instrumenteve OES. Aplikimi i teknikës OES.
Java e pesëmbëdhjetë:	Vlerësimi i dytë intermediar
Java	Ushtrimet
Java e parë	Hyrje në Spektroskopi Molekulare, metodat spektroskopike, parimet e punës.
Java e dytë	Matja e spektrit të pesë komponimeve me grupe kromofore me spektrofotometër UV-VIS me një rreze, gjetja e λ maksimale sipas spektrit të matur.
Java e tretë	Matja e absorbancës të pesë komponimeve me grupe kromofore, përcaktimi i përqendrimit duke zbatuar Ligjin e Lambert-Beer-it.
Java e katërt	Spektroskopia me rreze IK, principet e punës, metoda me disqe të KBr-së dhe ATR. Matja e spektrit të pesë komponimeve me disqe të KBr-së.
Java e pestë	Matja e spektrit të pesë komponimeve me disqe të ATR. Interpretimi i spektrave IK në bazë të sinjaleve të fituara.
Java e gjashtë dhe e	Komentimi i spektrave të shembujve të ndryshëm të spektrave

<i>shtatë</i>	UV, IK, 1H dhe 13C RBM dhe MS me strukturë të njohur (me formula strukturale).
<i>Java e tetë dhe e nëntë</i>	Komentimi i spektrave të shembujve të ndryshëm të spektrave UV, IK, 1H dhe 13C RBM dhe MS me strukturë të panjohur (pa formula strukturale).
<i>Java e dhjetë dhe e njëmbëdhjetë</i>	Komentimi i spektrave të shembujve të ndryshëm të spektrave UV, IK, 1H dhe 13C RBM dhe MS me strukturë të njohur (me formula empirike).
<i>Java e dymbëdhjetë dhe e trembëdhjetë</i>	Shembuj të ndryshëm të spektrave UV, IK, 1H dhe 13C RBM dhe MS me struktura të panjohur (pa formula empirike).
<i>Java e katërbëdhjetë</i>	Përcaktimi me SAA dhe SEF i një mostre me përbërje të njohur.
<i>Java e pesëmbëdhjetë</i>	Kollokfium për testim të njohurive të fituara.

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Vijimi i rregullt i studentëve në ligjërata është i dëshirueshëm kurse në ushtrime është i obligueshëm. Ardhja me kohë në ligjërata dhe ushtrime është e obligueshme. Gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve shkyçja e telefonave është e domosdoshme.

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	FSHMN: Departmenti i Kimisë
Titulli i lëndës:	Inxhinieria e reaksioneve kimike
Niveli:	Bachelor – drejtimi Kimi Inxhinierike
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	III (I tretë) / Semestri i V
Numri i orëve në javë:	2+2
Vlera në kredi – ECTS:	4
Koha / lokacioni:	E Premte, 08⁰⁰-09³⁰
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Asist. Flamur Sopaj
Detajet kontaktuese:	Email: flamur.sopaj@uni-pr.edu Tel: 049 386 931
Përshkrimi i lëndës	<p>Reaksionet në mjedis homogjen në reaktor ideal. Kinetika e reaksioneve homogjene dhe analiza e variablave që e kushtëzon atë. Parashikimi i shpejtësisë së reaksioneve nga konceptet teorike. Interpretimi i të dhënave të reaktorit statik. Reaktori statik me vëllim konstant dhe të ndryshueshëm. Hyrje në dizajnin e reaktorëve. Reaktorët ideal dhe dizajni i tyre për reaksionet e thjeshta njëstadëshe si dhe ato paralele. Reaksionet multiple, zingjirë. Ndikimi i temperaturës dhe shtypjes për reaksionet e thjeshta dhe multiple. Zgjedhja e llojit të duhur të reaktorëve. Format e rrjedhjes në reaktor, kontakti dhe rrjedhja joideale. Modeli i dispersionit, seritë e reaktorëve, përzierja dhe konveksioni. Katalizatorët e ngurt të reaksioneve kimike. Reaktori katalitik i mbushur (packed bed). Reaktorët me katalizator të ngurt të suspenduar dhe ata me fluid. Katalizatorët deaktivizues. Reaksionet në katalizatorë të ngutë. Sistemet jokatalitike. Sistemet e reaksioneve biokimike.</p>

Qëllimet e lëndës:	Kuptimi dhe aplikimi i koncepteve të kinetikës kimike në inxhinierinë e reaksioneve kimike. Njohja e karakteristikave të reaktorëve dhe modelimi i tyre. Zgjedhja e një reaktori të përshtatshëm për procesin e caktuar dhe llogaritja e parametrave të tijë. Kuptimi i formave të rrjedhjes së lëndës në reaktor dhe devijimit nga rrjedhja ideale si dhe zgjidhja e një problemi të tillë.		
Rezultatet e pritura të nxënies:	<p>Pas përfundimit të këtij kursi studentët do të jenë në gjendje:</p> <p>Të kuptojnë dhe të jenë në gjendje përdorin ekuacionet e reaksioneve të ndryshme kimike për analizën dhe parashikimin e tyre.</p> <p>Të bëjnë analizën e parametrave të një procesi në bazë të njohurive të kinetikës kimike, njohjes së modeleve të reaktorëve të ndryshëm, proceseve të transportit dhe operacioneve matematikore.</p> <p>Të aplikojnë njohuritë e fituara nga modelet e reaktorëve për të njuhësuar efikasitetin e tyre.</p> <p>Të përdorin njohuritë nga kursi për të vlerësuar kushtet optimale për një proces të dhënë që zhvillohet në reaktor.</p> <p>Dizajnojnë një reaktor për një proces të caktuar.</p>		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike	-	-	
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	6	6
Ushtrime në teren	-	-	
Kollokfiime,seminare	1	2	2
Detyra të shtëpisë	1	5	5
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	15	15
Përgaditja përfundimtare për provim	2	5	10
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	2	1	2

Projektet,prezentimet ,etj			
Totali	12	64	100
Metodologjia e mësimdhënies:	Ligjërata (metoda interaktive dhe monolog), punim seminarik, ushtrime praktike dhe numerike, diskutim, punë në grupe.		
Metodat e vlerësimit:	<ul style="list-style-type: none"> • Pjesëmarrja aktive në ligjërata dhe ushtrime 10 % • Punimi seminarik 20 % • Vijimi i rregullt 10 % • Provimi final (me shkrim) 60 % 		
Literatura			
Literatura bazë:	Octave Levenspiel, <i>Chemical Reaction Engineering</i> , 3-rd ed., John Wiley and Sons, 1999.		
Literatura shtesë:	H. Scott Folger, <i>Elements of Chemical Reaction Engineering</i> , 3-rd ed., Prentice-Hall; 1999. G. W. Roberts, <i>Chemical Reactions and Chemical Reactors</i> , Wiley, 2008.		

Plani i dizajnuar i mësimimit:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
Java e parë:	Pasqyrë e shkurtër e inxhinierisë së reaksioneve kimike. Kinetika e reaksioneve homogjene. Interpretimi i të dhënave të reaktorit statik (batch).
Java e dytë:	Hyrje në dizajnin e reaktorëve. Reaktorët ideal për reaksionet e thjeshta një etapshe.
Java e tretë:	Dizajni për reaksionet e thjeshta. Dizajni për reaksionet paralele.
Java e katërt:	Seri të reaksioneve multiple. Ndikimi i shtypjes dhe temperaturës, reaksionet e thjeshta the ato multiple. Zgjedhja e reaktorit të duhur.
Java e pestë:	Bazat e rrjedhjes joideale. Modelet e dhomëzave. Modeli i dispersionit.
Java e gjashtë:	Vlerësimi i parë intermediar
Java e shtatë:	Modeli i reaktorëve (tankeve) në seri. Modeli i konveksionit për rrjedhën laminare. Përzierja fillestare, segregimi (ndarja) dhe RTD.
Java e tetë:	Reaksionet heterogjene. Reaksionet e katalizuara nga

	substancat e ngurta.
Java e nëntë:	Reaktori katalitik i mbushur (packed bed). Reaktoret me katalizator të ngurt në suspension, reaktorët me fluid të tipeve të ndryshëm. Katalizatorët deaktivizues.
Java e dhjetë:	Katalizatorët deaktivizues. Reaksionet G/L në katalizatorë të ngurt. Reaktori me rrjedhje të vogël (trickle bed). Reaktori me fazë gjysëm të lëngshme (slurry). Reaktori tri-fazor me fluid (fluidized bed).
Java e njëmbëdhjetë:	Sistemet jokatalitike. Kinetika e reaksioneve fluid – fluid. Dizajni i reaksioneve fluid – fluid.
Java e dymbëdhjetë:	Kinetika e reaksioneve fluid – grimcë. Dizajni i reaksioneve fluid – grimcë.
Java e trembëdhjetë:	Sistemet e reaksioneve biokimike. Fermentimi enzimatik dhe mikrobial.
Java e katërbëdhjetë:	Fermentimi mikrobial i kufizuar nga substrati. Fermentimi mikrobial i kufizuar nga produkti.
Java e pesëmbëdhjetë:	Vlerësimi i dytë intermediar
Java	Ushtrimet
Java e parë:	Planprogrami dhe përsëritje nga kinetika kimike.
Java e dytë :	Ushtrime numerike, kinetika e reaksioneve homogjene në reaktorë ideal.
Java e tretë:	Kinetika e oksidimit të jodureve me peroksidisulfat në reaktorin statik.
Java e katërt :	Kinetika e oksidimit të jodureve në reaktorin gjysme static.
Java e pestë:	Ndikimi i përzierjes në shpejtësinë e tretjes së oksigjenit në ujë në reaktorin gjysmëstatik.
Java e gjashtë:	Matja e performancës së reaktorit me përzierje dhe rrjedhje të vazhdueshme.
Java e shtatë:	Ushtrime numerike, format e rrjedhjes dhe rrjedhja joideale.
Java e tetë:	Përcaktimi i shpejtësisë së hollimit të tretësirës së CuSO ₄ në reaktorin gjysmëstatik dhe atë të vazhdueshëm.
Java e nëntë dhe e dhjetë:	Përcaktimi i shpërndarjes së shpejtësive të rrjedhjes në reaktorin e mbushur (packed bad) sipas dimensioneve të grimcave.
Java e njëmbëdhjetë:	Përcaktimi i kohës së nevojshme për trajtimin e një vëllimi të reaktorit me mbushje.
Java e dymbëdhjetë:	Përcaktimi i numrit të vëllimeve të reaktorit me mbushje që mund të trajtohen për një kohë të dhënë.
Java e trembëdhjetë:	Matja e shpërndarjes së kohës së daljes për permanganatin e kaliumit nga një reaktor me anë të metodës puls dhe asaj me ndryshim të llojit të fluidit.
Java e katërbëdhjetë:	Test.

<i>Java e pesmbëdhjetë:</i>	Kontrollimi i ditarëve dhe përsëritje.
------------------------------------	--

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:
--

Vijimi i ligjëratave dhe ushtrimeve duhet të jetë i rregullt. Kërkohej disipline maksimale dhe respektim të rregullave të sjelljes akademike. Për specifikën e organizimit të ligjëratave dhe ushtrimeve studentët njoftohen me kohë nga ligjëruesi i lëndës.

Formular për SYLLABUS të Lëndës

Të dhëna bazike të lëndës			
Njësia akademike:	Departamenti i Kimisë		
Titulli i lëndës:	Kimia Koloidale		
Niveli:	Bachelor (inxh)		
Statusi lëndës:	obligative		
Viti i studimeve:	III		
Numri i orëve në javë:	2+2		
Vlera në kredi – ECTS:	5		
Koha / lokacioni:			
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Asist. Flamur Sopaj		
Detajet kontaktuese:	flamur.sopaj@uni-pr.edu		
Përshkrimi i lëndës	<p>Hyrje në kimine koloidale, Përgatitja dhe pastrimi i tretësirave koloidale. Llojet e veçanta të sistemeve shumëfazore. Vetitë specifike mekanike ,optike, elektrike dhe kinetike. Dukurite sipërfaqësore. Vetitë reologjike. Koagulimi i tretësirave koloidale. Agregatet e grimcave koloidale (xhelet dhe makromolekulat).</p>		
Qëllimet e lëndës:	<p>Qëllimi i këtij kursi është që studentet të fitojnë njohuri elementare për tipet, metodat e përgatitjes, pastrimit si dhe vetitë e tretësirave koloidale. Gjithashtu ky kurs do të ua lehtësoi studentëve njohjen proceseve themelore në analizën dhe prodhimin e materialeve të ndryshme në industri.</p>		
Rezultatet e pritura të nxënies:	<p>Pas përfundimit të këtij kursi studentët do të jenë në gjendje:</p> <ul style="list-style-type: none"> Të njohin sistemet koloidale dhe vetitë themelore të tyre. Të njohin dukuritë sipërfaqësore dhe implikimin e tyre në sistemet koloidale. Të fitojë shkathësi dhe përvojë të mjaftueshme për përgatitjen e tretësirave koloidale. Të njohin sistemet koloidale të rëndësishme për kuptimin e lamive interdisciplinare nga shkenca për materialet, dukuritë në atmosferë, prodhimet industriale të ushqimit e deri te proceset biologjike. Të mund t'i zbatojnë njohuritë në laboratore hulumtuese apo në ato industriale. 		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënies të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej

Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	2	3	6
Ushtrime në teren			
Kollokfiume, seminare	1	10	10
Detyra të shtëpisë			
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	15	30
Përgaditja përfundimtare për provim	3	5	15
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	2	2	4
Projektet, prezentimet ,etj			
Totali	14	65	125

Metodologjia e mësimdhënies:	ligjërata, seminar, ushtirime,diskutim, punë në grupe.
Metodat e vlerësimit:	Vlerësimi i parë: 25% Vlerësimi i dytë 25% Detyrat e shtëpisë dhe angazhime tjera 15% Vijimi i rregullt 5% Provimi final 30% Total 100%
Literatura	
Literatura bazë:	T. Cosgrove: Colloid Science, Principle, Methods and Applications, Blackwell P. 2005, H.Karagjozi, Kimia fizike dhe koloidale 2 Tiranë 1997.
Literatura shtesë:	R. Pashley: Applied Colloid and Surface Chemistry, Wiley, 2004. H. Danglia, Kimia koloidale (I, II, III), Tiranë 1985.

Plani i dizajnuar i mësimet:	
	Plani i dizajnuar i mësimet:
Java	Ligjëratat
<i>Java e parë:</i>	Dispersioni, sistemet disperse. Klasifikimi i tyre.
<i>Java e dytë:</i>	Tretësirat koloidale, vetitë specifike të tyre.
<i>Java e tretë:</i>	Klasifikimi i sistemeve koloidale.

<i>Java e katërt:</i>	Përgatitja e tretësirave koloidale, metodat e përgatitjes. Pastrimi i sistemeve koloidale, metodat e pastrimit.
<i>Java e pestë:</i>	Madhësia dhe forma e grimcës koloidale, mënyrat e përcaktimit. Struktura fiziko-kimike e koloideve.
<i>Java e gjashtë:</i>	Dukurite sipërfaqesore.
<i>Java e shtatë:</i>	Vlerësimi i parë intermediar.
<i>Java e tetë:</i>	Paqëndrueshmëria e koloideve, koagulimi i sistemeve koloidale.
<i>Java e nëntë:</i>	Agregatet e grimcave koloidale (xhelet dhe membranat).
<i>Java e dhjetë:</i>	Vetitë strukturale mekanike dhe optike të sistemeve koloidale.
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Vetitë kinetike, levizja Brauniane, difuzioni, sedimentimi dhe shtypja osmotike.
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Vetitë elektrike të sistemeve koloidale. Dukuritë elektrokinetike.
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Sistemet koloidale specifike (emulsionet, shkumat, arosolet).
<i>Java e katërmëdhjetë:</i>	Vetitë reologjike të sistemeve koloidale.
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Vlerësimi i dytë intermediar.

Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ushtrimet që do të zhvillohet
<i>Java e parë:</i>	Përgatitja e tretësirave koloidale.
<i>Java e dytë:</i>	Përcaktimi i vetive kryesore të tretësirave të ndryshme koloidale.
<i>Java e tretë:</i>	Përcaktimi i madhësive dhe shpërndarjes së madhësive së grimcave.
<i>Java e katërt:</i>	Ndarja e koloideve me metoda të ndryshme.
<i>Java e pestë:</i>	Përcaktimi i stabilitetit të tretësirave koloidale. Koagulimi.
<i>Java e gjashtë:</i>	Përcaktimi i vetive mekanike. Përcaktimi i viskoziteti.
<i>Java e shtatë:</i>	Përcaktimi i vetive optike.
<i>Java e tetë:</i>	Përcaktimi i vetive kinetike.
<i>Java e nëntë:</i>	Përcaktimi i vetive elektrike.
<i>Java e dhjetë:</i>	Përcaktimi turbidimetrik i përqendrimit të koloideve.
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Përcaktimi i fenomenit të Tjendallit me AgNO ₃ .
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Përcaktimi i vetive reologjike të koloideve.
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Përcaktimi i parametrave të adsorbimit.
<i>Java e katërmëdhjetë:</i>	Përgatitja e tretësirave të makromolekulave.
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Përgatitja e xhelit dhe membranës.

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Vijimi i rregullt në ligjerata i domosdoshëm kurse në ushtrime i obligueshëm. Prania me kohe në ligjerata dhe ushtrime e domosdoshme. Aparatet elektronike që pengojnë në mësim duhet shkyqur.

Formular për SYLLABUS të Lëndës

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore Departamenti i Kimisë
Titulli i lëndës:	Kimia Fizike II
Niveli:	Bsc
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	II
Numri i orëve në javë:	3
Vlera në kredi – ECTS:	7
Koha / lokacioni:	E Enjte/ 13:30 – 15:45/ Departamenti i Kimisë
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Ass. Dr. Makfire Sadiku
Detajet kontaktuese:	makfire.sadiku@uni-pr.edu ; 044-166-499
Përshkrimi i lëndës	Kursi do të merret me shpejtësinë e reaksioneve kimike, sqarimin e mekanizmave nëpër të cilët kalojnë reaksionet kimike dhe faktorët që ndikojnë në shpejtësinë e proceseve kimike duke përfshirë katalizën si pjesë e kinetikës kimike. Në elektrokimi do të trajtohen ligjet e veprimit dhe korrelacionet që ekzistojnë midis fenomeneve kimike dhe elektrike. Do të trajtohet teoria e elektroliteve, termodinamika e proceseve elektrokimike dhe kinetika e këtyre proceseve, që përbëjnë një nga bazat themelore të kësaj lëmie.
Qëllimet e lëndës:	Ky kurs ka për qëllim krijimin e njohurive bazë për shpejtësinë dhe rendin e reaksioneve kimike, mekanizmat e tyre, llojin e reaksioneve dhe veprimin e katalizatorëve, proceseve elektrokimike përfshirë dy kapituj kryesorë të elektrokimisë, termodinamikën elektrokimike dhe kinetikën elektrokimike që përbëjnë një nga bazat themelore i këtij subjekti.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit të kursit, studentët duhet: Të kenë koncepte të formuara në bazë të të cilave mund të bie përfundime të sigurt për shpejtësinë e reaksioneve, mekanizmave të tyre, për llojin e reaksioneve Të dijnë të sqarojnë ndikimin e faktorëve të ndryshëm në shpejtësinë e reaksionit kimik

	<p>Të kenë bazë për shtruarjen eksperimentale të problemeve.</p> <p>Të kenë bazë të mjaftueshme teorike dhe praktike për të sjellë konkluzione për veprimin e katalizatorëve të llojeve të ndryshëm dhe zbatimin e tyre për rritjen e rendimentit në proceset e prodhimit.</p> <p>Të japin përgjigje për proceset elektrokimike që përfshihen në dy kapituj kryesor të saj, termodinamikën dhe kinetikën elektrokimike që përbëjnë bazat themelore e kësaj lëmie, proceset që zhvillohen gjatë kalimit të rrymës në tretjet elektrolitike.</p>		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	3	15	45
Ushtrime teorike/laboratorike	3	15	45
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	5	5
Ushtrime në teren			
Kollokuiume/seminare	2	2	4
Detyra të shtëpisë	1	6	6
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	3	10	30
Përgaditja përfundimtare për provim	2	12	24
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	2	5	10
Projektet,prezentimet ,etj	2	3	6
Totali	20	70	175
Metodologjia e mësimdhënies:	Ligjërata, ushtrime numerike, ushtrime laboratorike		
Metodat e vlerësimit:	Vlerësimi i parë: 15 %, Vlerësimi i dytë: 15 %, Detyrat e shtëpisë dhe seminarët: 5 %, Vijimi i rregullt: 15 %, Testi final: 50 %,		

	Total 100 %.
Literatura	
Literatura bazë:	<p><i>P. W. Atkins, Physical Chemistry, Eighth Edition, Oxford Univ. Press, Oxford, 2006</i></p> <p><i>P. W. Atkins and Julio de Paula, Elements of Physical Chemistry, Fifth Edition, Oxford University Press, 2009.</i></p> <p>Makfire Sadiku, Kimia Fizike II, Dispensë, Prishtinë, 2023.</p>
Literatura shtesë:	<i>Robert .G. Mortimer, Physical chemistry, third ed. Elsevier Academic Press, 2008</i>

Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
<i>Java e parë:</i>	Hyrje në kinetikë, Rendi i reaksionit, Molekulariteti i reaksionit, Ligjet e shpejtësisë
<i>Java e dytë:</i>	Reaksionet e rendit të parë, dytë dhe zero, Përcaktimi i rendit të reaksionit
<i>Java e tretë:</i>	Ndikimi i temperatures në shpejtësinë e reaksionit, teoria e goditjes, energjia e aktivizimit.
<i>Java e katërt:</i>	Kinetika e reaksioneve të përbëra, Reaksionet fotokimike
<i>Java e pestë:</i>	Teoria e adsorbimit, izotermat e adsorbimit.
<i>Java e gjashtë:</i>	Kataliza dhe tipet e katalizës, Kataliza homogjene dhe heterogjene.
<i>Java e shtatë:</i>	Kataliza acido-bazike dhe Kataliza enzimatike
<i>Java e tetë:</i>	Vlerësimi i parë intermediar
<i>Java e nëntë:</i>	Hyrje në elektrokimi, reaksionet dhe ligjet e elektrolizës,
<i>Java e dhjetë:</i>	Përcjellshmëria elektrike e elektrolitëve, përcjellshmëria molare, lëvizshmëria e joneve, faktorët që ndikojnë në lëvizshmërinë e joneve.
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Teoria e Arrhenius-it për jonizimin, lëvizshmëria e joneve, shpejtësia relative e joneve. Numri i transportit të joneve, përcaktimi i numrit të transportit të joneve metoda e Hittorf-it .
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Gjysëmelementet, elementet elektrokimike, FEM, llogaritja e FEM së elementit galvanik.
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Marrëdhënia në mes FEM dhe energjisë së lirë, ekuacioni i Nernst-it, llogaritja e konstantës së ekuilibrit për reaksionin e lëmintit galvanik.
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	Potenciali elektrodik në kufinj të ndarjes së fazave, Elektrodat
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Vlerësimi i dytë intermediar

Plani i dizajnuar per ushtrime laboratorike	

Java	Ushtrimt laboratorik
<i>Java e parë:</i>	Njoftim me planprogramin dhe organizimin e ushtrimeve
<i>Java e dytë:</i>	Kinetika e ftohjes së ujit
<i>Java e tretë:</i>	Ndikimi i katalizatorit në shpejtësinë e oksidimit të jodureve me persulaft. Zhvillimi i reaksionit pa prani të katalizatorit dhe në prani te katalizatorit CuSO ₄
<i>Java e katërt:</i>	Zhvillimi i reaksionit në prani të katalizatorit FeSO ₄ dhe zhvillimi i reaksionit në prani të dy katalizatorve CuSO ₄ dhe FeSO ₄
<i>Java e pestë:</i>	Përcaktimi i shpejtësisë së hidrolizës së etilacetatit në mes acidik
<i>Java e gjashtë:</i>	Shpejtësia e inversionit të saharozës
<i>Java e shtatë:</i>	Izoterma e Gibbs-it
<i>Java e tetë:</i>	Izoterma e Frenlich-ut
<i>Java e nëntë:</i>	Kollokiumi I (Kinetikë kimike)
<i>Java e dhjetë:</i>	Matja e forcës elektromotore të elementit normal
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Përcaktimi i konstantës së jonizimit në mënyrë konduktometrike
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Përcaktimi konduktometrik i produktit të tretshmërisë
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Përcaktimi i përqueshmëris elektrike për elektrolit me fortësi të ndryshme
<i>Java e katërmbëdhjetë:</i>	Matja e entalpisë së një reaksionit kimik duke matur forcën elektromotore
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Kollokiumi II (Elektrokimi)

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:
Vijimi i rregullt në ligjëratat dhe ushtrime si dhe aktiviteti gjatë orëve të ligjëratave dhe ushtrimeve.